



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.27

19 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr.4, datë 25.2.2009	Me objekt: shpalljen e vendimit nr.00-2008-147, datë 1.2.2008 të dhomës së këshillimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë	1565
Vendim i GJK nr.5, datë 6.3.2009	Me objekt: shfuqizimin e neneve 24/5, 327, pika 2; 328 dhe 329, pika 1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston” të Kodit të Procedurës Penale, si të papajtueshme me Kushtetutën	1571
Vendim i GJK Nr.6, datë 6.3.2009	Me objekt: konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	1578
Vendim i GJK nr.7, datë 9.3.2009	Me objekt: 1. Shpalljen e vendimit nr.166, datë 6.3.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën 2. Pezullimin e këtij vendimi deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.....	1583

VENDIM
Nr.4, datë 25.2.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 1.10.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.18/5 Akti që i përket:

KËRKUES: ILIAZ BICI, biri i Abazit, datëlindja 1947, banues në fshatin Dragostunjë, komuna Qendër, Librazhd, i përfaqësuar nga avokat Arqile Nini – me prokurë të posaçme.

SUBJEKTI I INTERESUAR: SHOQËRIA “ALBANIA TABAK-Fabrika e Re e Cigareve” sh.p.k., Librazhd, përfaqësuar nga z. Oljon Kaso dhe znj. Natasha Laska, me autorizim.

OBJEKTI: Shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2008-147, datë 1.2.2008 të dhomës së këshillimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoj pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoj rrëzimin e kërkesës dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuarit Iliaz Bici, me vendimin nr.589, datë 22.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është kthyer në pronësi sipërfaqja 2000 m², me nr. pasurie 499/6, e ndodhur në zonën kadastrale 2446, Librazhd.

Duke qenë se sipërfaqja e kthyer më sipër rezultonte e zënë nga shoqëria “Albania-Tabak” sh.p.k., Librazhd, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd me padinë me objekt “*Kthim sendi dhe detyrim për pagimin e qerasë së shfrytëzimit të sendit truall për periudhën 11.6.2001 deri në dorëzimin e truallit*”.

Në përfundim të gjykimit, kjo gjykatë, pasi konstatoi se “*trualli i paditësit gjendet në kufi me pronat e së paditurës, e cila aktualisht zotëron edhe truallin e paditësit*”, me vendimin nr.62, datë 13.03.2002, vendosi “*pranimin e kërkesëpadisë*”.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.302, datë 30.5.2002, ka vendosur “*Prishjen e vendimit nr.62, datë 13.3.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë*”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd, me vendimin nr. 221, datë 19.6.2003, ka vendosur “*Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit Iliaz Bici dhe “Rrëzimin e kundërpadisë së Shoqatës “Albania Tabak – Fabrika e re e cigareve” sh.p.k., Librazhd*”.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.603, datë 24.12.2004, ka vendosur “*Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Iliaz Bici, si e pambështetur në ligj e në prova*” dhe “*Pranimin e kundërpadisë pjesërisht*”.

Pas rekursit të bërë nga ana e kërkuarit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 507, datë 25.4.2006, ka vendosur “*Lënien në fuqi të vendimit nr.603, datë 24.12.2004 të Gjykatës së Apelit Durrës*”.

Kërkuari Iliaz Bici, me cilësinë e palës së interesuar (paditës në padinë objekt gjykimi), në bazë të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile ka kërkuar në Gjykatën e Lartë rishikimin e vendimit nr.221, datë 19.6.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Si “*provë e re me shkrues me rëndësi për çështjen, e cila nuk mund të dihej nga pala gjatë shqyrtimit të saj*”, përpara Gjykatës së Lartë kërkuari ka paraqitur një hartë të quajtur planrivelimi e datës 13.7.2001, e zonës kadastrale 2466 me nr. pasurie 499/2, në të cilën tregohet prona e shoqërisë, Albania – Tabak, Fabrika e Re e Cigareve” sh.p.k., Librazhd, e nënshkruar nga pronari i kësaj shoqërie. Nga harta rezulton se midis pronës së shoqërisë së mësipërme dhe pronës së kërkuarit nuk ka mbivendosje, përfundim ky i njëjtë me atë të vendimit nr.62, datë 13.3.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, vendim i cili është ndryshuar nga kjo gjykatë me vendimin nr.221, datë 19.6.2003.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2008-146, datë 1.2.2008, ka vendosur “*Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga Iliaz Bici, për rishikimin e vendimit nr.221, datë 19.6.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd*”.

Kërkuari, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor, duke argumentuar në këto drejtime kryesore:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale civile dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Ky Kolegj kryen një shqyrtim paraprak dhe vlerëson nëse prova e re i përmban kriteret ligjore për rishikimin e vendimit. Rëndësia thelbësore e provës së re për zgjidhjen e çështjes, nuk mund të gjykohej në dhomën e këshillimit, por në seancë gjyqësore. Në rastin në shqyrtim, nga pikëpamja formale, prova e re e paraqitur i përmban elementet e kërkuar nga neni 194 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile.

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është marrë nga një trupë gjyqtarësh, e cila ka krijuar një dyshim të bazuar tek kërkuari për njëanshmërinë e saj. Në të dy gjykimet e zhvilluara në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë kanë marrë pjesë dy gjyqtarë (njëri nga të cilët ka qenë edhe relator i çështjes gjatë shqyrtimit të rekursit të paraqitur prej kërkuarit në këtë gjykatë). Në të dy rastet, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë vendime kundër interesave të kërkuarit.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar:

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit është ligjor dhe në përputhje me kërkesat e neneve 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Është në diskrecionin e dhomës së këshillimit të vlerësojë faktin nëse kërkesa plotëson kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji. Në dhomën e këshillimit nuk zhvillohet një gjykim themeli, por një gjykim formal, ku përcaktohet vetëm nëse kërkesa i plotëson kërkesat e nenit 497 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

- Pretendimi i ngritur nga kërkuari për cenim të parimit të paanshmërisë, për shkak të pranisë së dy gjyqtarëve si në gjykimin e themelit, ashtu edhe në shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, është i pabazuar. Rastet në të cilat gjyqtari ka pengesë ligjore të marrë pjesë në gjykimin e një çështje janë të përcaktuara në nenet 72 e 73 të Kodit të Procedurës Civile. Në çështjen konkrete nuk ndodhemi përballë këtyre rasteve, sepse asnjëri prej tyre nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në ndonjë shkallë tjetër të gjykimit. Shqyrtimet në dhomën e këshillimit kanë të bëjnë vetëm me vlerësimin e kriterëve ligjore për kalimin ose jo në seancë gjyqësore dhe nuk përmbajnë karakteristikat e gjykimeve të mirëfillta, duke mos e cenuar në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

II

1. Kjo kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), është paraqitur nga kërkuari, duke iu referuar nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës, me arsyetimin e cenimit të rregullsisë së procesit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit.

2. Në lidhje me pretendimin e parë të kërkuarit, që lidhet me natyrën e gjykimin në dhomën e

këshillimit, në jurisprudencën e saj Gjykata ka konkluduar se nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për rishikimin, si dhe nga vetë vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që kanë interpretuar ato dispozita, rezulton se kërkesa për rishikimin e një vendimi civil të formës së prerë shqyrtohet nga kolegji civil, në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, rezulton gjithashtu se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, verifikon fillimisht rastet e rishikimit, legjitimitetin e kërkesës, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesës për rishikimin e vendimit si dhe praninë e kriterëve ligjore për shqyrtim e saj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim, por nëse këto kriterë plotësohen, gjykata nuk mund të vendosë drejtpërdrejt prishjen e vendimit, pa respektuar parimet kushtetuese të dëgjimit të palëve e të barazisë së mjeteve” (*Shih vendimet nr. 8/2002, 104/2002, 6/2003, 17/2005, 8/2006 dhe 5/2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për të njëjtin pretendim, Gjykata është shprehur se “... kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton *haptazi e pambështetur*, gjykata vendos mospranimin e saj”. Nga ky përcaktim ligjor kuptohet se shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë, kur ajo është bërë jashtë kriterëve ligjore, bëhet në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Një verifikim i tillë i kërkesës, nëse i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, është atribut i dhomës së këshillimit dhe jo i seancës gjyqësore. Aq më tepër që mospranimi i kërkesës vendoset pas këtij shqyrtimi paraprak dhe jo në seancë gjyqësore. Prandaj, përcaktimi në ligj se në këto raste gjykata vendos mospranimin, dëshmon se shqyrtimi i kërkesës për rishikim për të verifikuar paraqitjen e saj sipas kriterëve ligjore, bëhet në dhomën e këshillimit. Ky është qëndrimi i ligjvënës, i përcaktuar edhe në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit” (*shih vendimin nr.20, datë 29.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Pretendimi i kërkesës në lidhje me çështjen në shqyrtim reduktohet te fakti që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij (si edhe në të tjerë të ngjashëm), ndërsa deklaron “mospranimin e kërkesës”, shprehet paraprakisht se “kërkesa për rishikim [...] nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile”. Kjo dispozitë ligjore në lidhje me çështjen vlen përse i takon rastit të parashikuar në pikën “a” të tij. Pra, “kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës ... kur: a) *zbulohen ... (1) prova të reja me shkresë, (2) që kanë rëndësi për çështjen, (3) të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj*”. Fakti që në shumicën e rasteve, palët paraqesin përpara Gjykatës një apo më shumë *prova të reja*, të cilat nuk mund të dihenin më parë nga pala dhe që sipas saj kanë rëndësi për çështjen, shtron debatin mbi rolin dhe funksionin e dhomës së këshillimit në të tilla raste.

Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së saj, thekson se në këtë rast, sikundër për pranimin ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminatory të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht, që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund ta deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Nga ana tjetër, në dallim nga vlerësimi lidhur me kriteret objektive dhe ligjore, si “*e re*”, “*me shkresë*” dhe “*të cilat nuk mund të dihen nga pala*”, kjo trupë nuk mund të mos arsyetojë dhe të konkludojë edhe mbi “*rëndësinë (apo themelësinë) e provës së re në lidhje me çështjen*”. Gjykata vëren se, pavarësisht konfondimit ligjor që mund të vihet re në praktikë ndërmjet shqyrtimit të çështjes nga dhoma e këshillimit apo nga kolegji në seancë gjyqësore, është një moment i rëndësishëm për procesin e rishikimit, gjatë të cilit dhoma e këshillimit ushtron, sipas nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile një kompetencë për vlerësimin në thelb të kërkesës që “*rezulton haptazi e pambështetur*”. Gjykata thekson se e gjithë kjo veprimtari seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t’iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Nga ana tjetër, përse i përket shqyrtimit paraprak mbi vetë rëndësinë e provës së re, Gjykata thekson se ky gjykim është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë të këshillimit dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata Kushtetuese.

Nga kjo analizë Gjykata konkludon se pretendimi i kërkesës për parregullsinë e procesit ligjor, për shkak të tejkalimit të kompetencave që ligji i ka dhënë dhomës së këshillimit gjatë

vlerësimit të kërkesës për rishikim, është i pabazuar.

3. Në lidhje me pretendimin e kërkuarit mbi cenimin e parimit të paanshmërisë së trupës së gjyqtarëve që përbënin dhomën e këshillimit, Gjykata thekson se analiza duhet zhvilluar nën dritën e jurisprudencës aktuale të vetë kësaj Gjykate, si edhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”*

Koncepti në shqyrtim është i njohur dhe mbrohet edhe nga aktet ndërkombëtare si: konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, konventa europiane për të drejtat e njeriut” (KEDNJ), të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, e për pasojë pjesë e të drejtës së brendshme të saj (nenet 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë). KEDNJ në nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), paragrafi “1”, parashikon: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj, e cila do të vendosë ... për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet me karakter civil ...”*

Në jurisprudencën e GJEDNJ është analizuar dhe janë dhënë edhe përkufizimet e nevojshme mbi nocionin *“gjykatë e paanshme”*. Në radhë të parë, jurisprudenca e kësaj gjykate ka konkluduar se një gjykatë duhet të jetë e tillë jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur: *“E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet”*.

*“Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor apo të procesit të drejtë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i konventës europiane për të drejtat e njeriut është edhe ai i paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e çështjes. Në këtë kuadër, Gjykata thekson se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë”* (shih vendimin nr.12, datë 13.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Karakteri thelbësor i rasteve të papajtueshmërisë i referohet në fakt hipotezës specifike në të cilën vlerësimi paragjykues, megjithëse është shprehur në një proces formalisht të ndryshëm nga aktual, i përket një ngjarjeje thelbësisht të njëjtë për procesin, që mund ose duhej të ishte gjykuar në kontekstin e vetë procesit. Paragjykimi eventual për paanshmëri e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. (shih më gjerë vendimet nr.283/2000 dhe nr.326/2002 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë).

Jurisprudenca e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar *“gjykatë e anshme”* trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm; Gjykata ka theksuar se *“thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuarin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje”* (shih vendimin nr.48, datë 30.7.1999 të Gjykatës Kushtetuese).

Në rastin në shqyrtim, rezulton se dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë kanë marrë pjesë në dy gjykime të iniciuara nga kërkuari. Gjykata çmon se një fakt i tillë nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtar, për çështje të ndryshme. I ndryshëm është qëndrimi, kur i njëjti gjyqtar apo gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore. Rezulton se dy nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët kanë shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuari dhe kanë konkluduar për drejtësinë e vendimit të gjykatës së apelit, që ka rrëzuar padinë

e kërkuessit, kanë shqyrtuar dhe kanë konkluduar edhe për mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit, të dhënë prej tyre. Gjykata vlerëson se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuessit në të dy gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të të njëjtës çështje gjyqësore.

Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të vlerësojë themelësinë e provës së re dhe rëndësinë e saj mbi çështjen, por vetëm të konkludojë nëse pjesëmarrja e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dy vendimet e dhëna për të njëjtën rrethanë të pretenduar, (ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi) ka krijuar një dyshim të justifikuar te kërkuessi se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm.

Si përfundim, Gjykata konkludon se pretendimi i kërkuessit për cenim të një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor dhe që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut, është i drejtë. Për rrjedhojë, kërkesa përta i përket pretendimit të dytë të kërkuessit është e bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f” dhe 134 pika 1 shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2008-147, datë 1.2.2008 të dhomës së këshillimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Petri Plloçi

MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës, për këto arsye:

Në Gjykatën e Lartë kërkuessi ka ushtruar dy mjete ankimi për goditjen e vendimit të formës së prerë, rekursin dhe kërkesën për rishikim.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në përbërje të të cilit kanë qenë edhe gjyqtarët I.B. dhe A.D., ka shqyrtuar rekursin në seancë gjyqësore dhe ka vendosur në disfavor të kërkuessit. Prezumohet se Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencën e saj kushtetuese dhe ligjore, ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar me rekurs vetëm nga pikëpamja e respektimit të ligjit material apo procedural.

Më vonë kërkuessi i drejtohet përsëri Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit të formës së prerë. Kërkesa për rishikim është shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe rezulton se anëtarë të kolegjit seleksionues kanë qenë edhe gjyqtarët I.B. dhe A.D. Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për rishikimin rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka kompetencën të vlerësojë ekzistencën ose jo të kushteve të pranueshmërisë së kërkesës në një shqyrtim seleksionues dhe nuk lidhet me vlerësimin e zgjidhjes së çështjes nga pikëpamja ligjore apo

faktike.

Sa më sipër, dy gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kanë luajtur role të ndryshme procedurale gjatë shqyrtimit të së njëjtës çështje. Në procesin e parë (gjatë shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore) kanë vlerësuar respektimin apo zbatimin e drejtë të ligjit, ndërsa në procesin e dytë (shqyrtimit të kërkesës për rishikim në dhomë këshillimi) kanë vlerësuar ekzistencën e ndonjë rasti nga ato që parashikon neni 494 i KPC, ose praninë e faktit ligjor.

Për të përcaktuar nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se trupës i mungon paanshmëria, dyshimi i kërkuarit është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Vendimtar mbetet përcaktimi se sa i justifikueshëm objektivisht është dyshimi mbi paanësinë e gjykatës.

Pra, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, nuk mjafton vetëm dyshimi apo frika e kërkuarit, por është i rëndësishëm objektiviteti i dyshimit.

Ndryshe nga shumica, mendoj se dyshimi i kërkuarit nuk është i justifikuar. Gjyqtarët në procedurën e shqyrtimit të kushteve të pranueshmërisë së kërkesës për rishikim, nuk vendosin nëse kishin gabuar apo jo në vendimin e mëparshëm, pasi rolet e tyre në këto procedura janë për shkaqe të ndryshme. Po ashtu, kufijtë e shqyrtimit nuk janë të paracaktuara dhe as të diktuar nga vendimi i mëparshëm.

Përfundimisht, në ndryshim nga sa argumenton shumica, mendoj se shqyrtimi në dhomë këshillimi i kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë, me praninë e dy gjyqtarëve të cilët më parë kanë qenë anëtarë në trupin gjykues të së njëjtës gjykatë (Gjykata e Lartë), gjatë shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore, nuk cenon paanshmërinë objektive të gjykatës.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr.5, datë 6.3.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 20.11.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.21/7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Apelit Vlorë, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, në mungesë.

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, përfaqësuar nga prokurori Bujar Sheshi, me autorizim.

Ministria e Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 24/5, 327 pika 2; 328 dhe 329 pika 1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston” të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, germa “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara; Kuvendin, që kërkoji rrëzimin e kërkesës dhe përfaqësuesin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm që kërkoji pranimin e saj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Fier, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Sh.H. për veprën penale të kryerjes së ekspertimit të rremë, në përfundim të hetimit të bërë, në bazë të nenit 328/1 të KPP-së, ka vendosur pushimin e procedimit penal me arsyetimin se fakti nuk ekziston. Kundër vendimit të prokurorisë, shtetasi Sh.H., në bazë të nenit 329/1 të KPP-së, ka paraqitur ankim në gjykatë duke pretenduar se argumentimi i prokurorisë është i pabazuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka shqyrtuar pretendimet e kërkuarit, me vendimin nr.489, datë 3.12.2007, ka vendosur mospranimin e ankimit kundër vendimit të pushimit të procedimit penal të prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke arsyetuar se, në zbatim të nenit 329/1 të KPP-së, kundër vendimeve të pushimit të çështjes penale nga ana e prokurorit mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri, përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston.

Mbi ankimin e shtetasit Sh.H., Gjykata e Apelit Vlorë mori në shqyrtim çështjen e mësipërme dhe arriti në përfundimin se neni 329/1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston”, nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur lidhur me kushtetutshmërinë e kësaj dispozite.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur para kësaj Gjykate edhe një vendim tjetër, me të njëjtin objekt, i cili i përket kallëzimit të bërë nga shtetasi H.Xh. pranë prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Në fund të hetimit, prokurori i çështjes ka vendosur pushimin e procedimit penal pasi ka vlerësuar se fakti nuk ekziston. Ky vendim i prokurorisë është ankimuar nga shtetasi H.Xh. pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë, e cila, me vendimin nr.240, datë 24.12.2007, ka vendosur rrëzimin e ankimit të tij, pasi sipas nenit 329/1, kundër vendimeve të pushimit të çështjes penale nga ana e prokurorit nuk lejohet ankim, në rastet kur, si shkak i pushimit, ka rezultuar se fakti nuk ekziston.

Gjykata e Apelit Vlorë, mbi bazën e ankimit të shtetasit H.Xh., ka shqyrtuar çështjen dhe ka arritur në përfundimin se neni 329/1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston” nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur lidhur me kushtetutshmërinë e kësaj pjesë të fjalisë.

Gjykata e Apelit Vlorë ka arsyetuar në vendimin e saj se e drejta e pushimit të çështjes nga prokurori, sipas nenit 327/2 dhe 328 të KPP-së, barazohet me dhënien e drejtësisë dhe kjo përbën cenim të nenit 148 të Kushtetutës. Kjo gjykatë argumenton se prokuroria duhet të ushtrojë ndjekjen penale dhe të përfaqësojë akuzën në gjyq. Sipas saj, është gjykata ajo që duhet të vendosë për fatin e mëtejshëm të procedimit penal dhe jo prokuroria. Arsyetohet gjithashtu se edhe kontrolli i vendimit të

prokurorit më të ulët nga prokurori më i lartë nuk është në përputhje me parimet procedurale penale dhe si rrjedhojë edhe me Kushtetutën, pasi i njeh prokurorit më të lartë rolin e dhënies së drejtësisë në çdo kohë. Ky parashikim nuk shoqërohet me afate të përcaktuara shprehimisht, me qëllim ushtrimin e të drejtës së prishjes së vendimit të prokurorit më të ulët.

Gjykata e Apelit Vlorë ka vlerësuar si jokushtetuese dispozitat e kundërshtuara duke parashtruar se:

- Vendimi i marrë nga prokurori për pushimin e çështjes ose akuzës në çdo fazë të procedimit, sipas nenit 329 të KPP-së, vjen në kundërshtim me funksionin kushtetues të tij që është ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës publike në gjyq, parashikuar në nenin 148/1 të Kushtetutës. Kjo vendimmarrje e prokurorit nuk ndjek rrugën e kontrollit nga një organ i i pavarur dhe i paanshëm siç është gjykata.

- Parashikimet e neneve 327/2, 328 dhe 329/1 të KPP-së shkelin parimin e dhënies së drejtësisë nga organi i ngarkuar me këtë funksion, duke ia kaluar atë në mënyrë përfundimtare organit të ngarkuar me ndjekjen penale.

- Dhënia formë të prerë vendimit të prokurorit në rastin kur ai arrin në përfundimin se fakti nuk ekziston, sipas nenit 329/1 të KPP-së, nuk pajtohet me nenin 43 të Kushtetutës, i cili parashikon të drejtën e ankimit të personave të interesuar ndaj çdo vendimi gjyqësor. Mohimi i të drejtës së ankimit ndaj vendimit të pushimit, të marrë nga organi i akuzës, është cenim i rëndë i të drejtave themelore të shtetasve.

- Përmbajtja e nenit 24/5 të KPP-së, i cili parashikon të drejtën e prokurorit më të lartë për të kontrolluar vendimmarrjen e prokurorit më të ulët, shkel parimin e paanësisë së organit të ngarkuar me dhënien e drejtësisë që është gjykata dhe nuk parashikon afate për ankimin kundër vendimit të prokurorit më të ulët.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara parashtruan qëndrimet e tyre, si më poshtë:

1. Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë:

- Shqyrtimi i pajtueshmërisë së neneve 327/2 dhe 328 me Kushtetutën është kryer më parë nga Gjykata Kushtetuese dhe për këtë arsye, nuk mund të jetë sërish objekt i gjykimit para kësaj Gjykate;

- Kërkuesi nuk paraqiti argumente të mjaftueshme lidhur me dispozitat konkrete të KPP-së të pretenduara si antikushtetuese dhe për këtë arsye i lihet në çmim kësaj Gjykate për t'u shprehur vetëm lidhur me kushtetutshmërinë e nenit 329/1 të KPP-së pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston”.

2. Përfaqësuesi i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm:

- Shqyrtimi i neneve 327/2 dhe 328 të KPP-së, për të cilat kërkohet shfuqizimi si antikushtetues përbën gjë të gjykuar, pasi Gjykata Kushtetuese e ka marrë tashmë në shqyrtim kërkesën me të njëjtën përmbajtje.

- Neni 329/1, pjesa e fjalisë që parashikon moslejimin e ankimit ndaj vendimit të pushimit të çështjes nga prokurori kur fakti nuk ekziston, bie ndesh me të drejtën e ankimit parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës. Përderisa Kushtetuta parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore, kjo e drejtë nuk mund të hiqet me dispozitat e KPP-së. Mosankimimi gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit nuk respekton garancinë e dhënies së drejtësisë si funksion kryesor i gjykatave:

- Pretendimi për shfuqizim të dispozitës që parashikon të drejtën e prokurorit më të lartë për të shfuqizuar vendimet e prokurorit më të ulët (neni 24/5 i KPP-së), nuk rezulton të ketë lidhje direkte midis çështjes në shqyrtim nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe dispozitës konkrete. Për këtë arsye, kjo kërkesë nuk duhet të jetë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë për mungesë legjitimitimi të kërkuesit.

II

Gjykata Kushtetuese vlerëson se të dyja vendimet e paraqitura nga Gjykata e Apelit Vlorë, megjithëse lidhen me procese gjyqësore të ndryshme të zhvilluara para asaj Gjykate, kanë në thelb kërkitë të njëjta sa i takon pretendimeve për papajtueshmëri me Kushtetutën të nenit 329/1 të KPP-së, pjesa e fjalisë “kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston”. Për këtë shkak, në bazë të nenit 330 të KPC-së, ajo vendosi bashkimin e kërkesave në një gjykim të vetëm.

III

1. Lidhur me pretendimin për gjë të gjykuar të nenit 327/2 dhe 328 të KPP

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara pretendojnë se pala kërkuese nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkimet për papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 327/2 dhe 328 të KPP-së, pasi ato kanë qenë më parë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese e çmon të bazuar argumentin e paraqitur nga subjektet e interesuara, duke theksuar se pajtueshmëria e neneve 327/2 dhe 328 të KPP-së me Kushtetutën është marrë në shqyrtim nga kjo Gjykatë mbi bazën e një kontrolli incidental të inicuar nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda. Me vendimin nr.14, datë 16.7.2008, është vendosur se këto dispozita janë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese i çmon kërkimet lidhur me këto dispozita si gjë të gjykuar duke lënë si objekt shqyrtimi vetëm nenin 329/1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston” të KPP.

2. Lidhur me pretendimin për legjitimit të kërkesit për nenin 24/5 të KPP

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar – Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm – parashtroi se kërkimet për papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitës që parashikon të drejtën e prokurorit më të lartë për të shfuqizuar vendimet e prokurorit më të ulët, nuk mund të jenë objekt i këtij shqyrtimi, pasi nuk plotësohen kushtet për të inicuar një gjykim incidental duke qenë se nuk ka lidhje të drejtpërdrejt midis kësaj dispozite dhe çështjes në shqyrtim nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Lidhur me pretendimin e mësipërm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kushtet për fillimin e gjykimit në rrugë incidentale janë parashikuar në nenin 145/2 të Kushtetutës dhe janë detajuar në nenin 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Sipas këtyre dispozitave, një gjykim i tillë vihet në lëvizje kur gjykata gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe ky ligj ka lidhje të drejtpërdrejt me zgjidhjen e çështjes konkrete. Në rastin në shqyrtim, përpara Gjykatës së Apelit Vlorë është paraqitur një ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes penale nga prokurori, vendim ky i mbështetur në nenin 328/1, shkronja “a” të KPP-së. Gjykata, gjatë shqyrtimit të çështjes, ka vlerësuar se në vetvete kompetenca e prokurorit për pushimin e çështjes është në kundërshtim me nenin 148/1 të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, ka çmuar se edhe nenet 24/2 dhe 24/5 të KPP-së janë në kundërshtim me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimi i subjektit të interesuar është i bazuar dhe duhet pranuar, mbështetur në nenin 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Këto dispozita jo vetëm që nuk janë dispozitat e zbatuara në rastin konkret, por nuk ekziston ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë midis tyre dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm. Për pasojë, Gjykata e Apelit Vlorë nuk legjitimohet për kundërshtimin e nenit 24/2 dhe 24/5 të KPP në kuadrin e një gjykimi incidental.

IV

1. Lidhur me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, sipas nenit 42 të Kushtetutës

Gjykata e Apelit Vlorë pretendon se neni 329/1 i KPP-së, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston”, bie ndesh me nenin 43 të Kushtetutës, i cili parashikon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Përballë kësaj dispozite kushtetuese vendoset përmbajtja e nenit 329/1 të KPP-së, sipas të cilës, kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri, *përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston*.

Kështu, nga grupi i çështjeve për të cilat i dëmtuari nuk mund të bëjë ankim, është përjashtuar rasti kur në vendim është shprehur se, fakti, i cili pretendohet nga kallëzuesi si kriminal, nuk rezulton të jetë real ose të paktën nuk arrin të vërtetohet si i tillë nga veprimet hetimore. Pra, kur prokurori është i bindur se nuk ndodhet para një veprimi ose mosveprimi të tillë që mund të ketë sjellë pasojë kriminale, me qëllim krijimin e një baze për të vazhduar hetimin e mëtejshëm ose dërgimin e çështjes në gjyq, ai vendos pushimin e çështjes penale.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozita që kërkohet të shfuqizohet duhet parë fillimisht në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës, duke u ndalur kryesisht në të drejtën e individit për t'iu drejtuar

gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë), si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese rithekson qëndrimin e saj se ndjekja penale, në kuptim të nenit 148 të Kushtetutës, është funksion ekskluziv i prokurorisë. I takon këtij organi, në bazë të Kushtetutës dhe sipas rasteve të përcaktuara në KPP-së, të ngrejë akuzë publike kur ndodhet para kryerjes së një veprë penale, e parashikuar si e tillë nga KP-ja. Parimi i përgjithshëm është që prokuroria ka tagrin për të filluar hetimin paraprak, i cili është një proces që përmban disa elemente si: thirrjen e dëshmitarëve dhe ekspertëve, marrjen e provave, kontrollin e banesës apo personit etj. Detyrimi kushtetues është që ndjekja penale të ushtrohet nga prokuroria. Mbi bazën e këtij detyrimi është ndërtuar i tërë KPP-ja, ku, tek kreu mbi prokurorinë, parashikohet hollësisht detyra e këtij organi gjatë procedimit penal duke e dalluar atë nga gjykatat ose organet e tjera pjesëmarrëse në gjykimin penal. Prokuroria, nëse ka prova, fillon ndjekjen penale ndaj personit të dyshuar si autor i veprës. Ky njihet ndryshe si parimi i ligjshmërisë, parim ku duhet të mbështetet vazhdimisht veprimtaria e prokurorisë. Përballë këtij parimi qëndron ai i oportunitetit, sipas të cilit i takon vetë prokurorit të vendosë se cilat çështje duhet të hetojë dhe sipas cilës rradhitje ose prioriteti (*shih vendimin e GJK-së nr.3, datë 6.2.2008*).

Për të garantuar jo vetëm qenien aktive të organit të prokurorisë në ndjekjen penale dhe dënimin e personave të dyshuar si autorë të veprave penale, por edhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve ndaj të cilëve ngrihet akuza ose janë dëmtuar si pasojë e veprës penale konkrete, ligjvënësi ka parashikuar në disa dispozita të KPP-së mundësinë që palët në proces, për çdo veprim që ata mendojnë se cenon të drejtat dhe liritë e tyre, t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës për kontroll (*shih vendimin e GJK-së nr.14, datë 16.7.2008*). Në këtë frymë, neni 278 i KPP-së, parashikon se gjatë hetimeve paraprake për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit dhe të dëmtuarit, vendos gjykata. Kjo dispozitë është miratuar nga ligjvënësi në vitin 2002, në kuadër të një koordinimi sa më të mirë të dispozitave që u japin palëve gjatë procesit të hetimeve paraprake disa të drejta procedurale. Më tej, në dispozitat e tjera të KPP-së, janë specifikuar disa nga rastet kur lejohet ankimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake.

Neni 329 i KPP-së parashikon se çdo i interesuar, në çdo fazë të procedimit, ka të drejtë të kërkojë në gjykatë pushimin e çështjes, kur ekzistojnë kushtet ligjore për mosfillimin e ndjekjes penale, mosvazhdimin ose shuarjen e saj. Kjo e drejtë për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, pra për t'u drejtuar një autoriteti të pavarur dhe të paanshëm, është në përputhje edhe me standardet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës. Në parim, ligjvënësi ia ka nënshtruar të gjitha veprimet hetimore paraprake kontrollit gjyqësor. Praktika njeh dy mënyra për ushtrimin e këtij kontrolli: ose nëpërmjet gjykatës, siç parashikon legjislacioni shqiptar ose nëpërmjet gjyqtarit hetues, i cili, në legjislacionet e disa vendeve, është organi kompetent për të kontrolluar të gjitha veprimet hetimore paraprake para se çështja t'i kalojë për gjykim gjykatës kompetente. Legjislatori shqiptar ka zgjedhur mënyrën e parë, sipas së cilës i lihet në vlerësim vetë personit të interesuar nëse dëshiron të ankimohet vendimet e prokurorit. Në fund është e drejtë e gjykatës të shprehet për të gjitha veprimet hetimore, përfshirë edhe vendimin e pushimit të çështjes. Gjykata, gjatë shqyrtimit të këtij vendimi duhet të konstatojë nëse prokurori e ka pushuar çështjen në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.

Parë në këtë këndvështrim, vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes nuk mund të konsiderohet si vendim i formës së prerë dhe i paankimueshëm gjyqësisht. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se vendimi i pushimit të çështjes nga prokurori nuk përbën dhënie drejtësie, kjo e fundit është kompetencë vetëm e gjykatës. Pikërisht për këtë shkak, palëve në proces duhet t'u krijohet mundësia që të përballen me drejtësinë edhe në rastin kur prokurori vendos pushimin e çështjes për shkak se fakti nuk ekziston. Është gjykata që, ashtu si në rastet e tjera të përmendura në nenin 328 të KPP-së, do të vlerësojë bazueshmërinë e veprimeve paraprake të prokurorit dhe shkaqeve që e kanë çuar atë në marrjen e vendimit të pushimit.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kur ushtron ndjekjen penale prokurori mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale, apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit, vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë, se në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë, në kontekstin penal, është ajo që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar vazhdimisht në praktikën e saj, se e drejta e ankimit gjyqësor të vendimeve të organeve të administratës publike duhet konsideruar si një e drejtë themelore autonome dhe si element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton mundësinë e individit për të kundërshtuar gjyqësisht një akt dhe ekzistencën e një organi të caktuar me ligj, të pavarur dhe të paanshëm, për shqyrtimin e ankimit. Pra, në vetëvete, ky nen sanksionon jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjithashtu, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e parë nga këndvështrimi i nenit 42/2 të Kushtetutës, i cili siguron zbatimin efektiv të një procesi të rregullt ligjor, ka për qëllim t'u garantojë palëve në proces të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'i vendosur ato në çdo rast në pozita të barabarta para gjykatës (*shih vendimet e GJK nr.15, datë 17.4.2003; nr.9, datë 2.4.2003; nr.17, datë 18.7.2005*).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se normat dhe parimet kushtetuese, ku bën pjesë edhe e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, përbëjnë bazën e nocionit të dhënies së drejtësisë. Administrimi i drejtësisë nga gjykata, që ka në themel të drejtën e personit për të pasur një arbitër të pavarur dhe të paanshëm, nënkupton shqyrtimin e një çështjeje që është përgatitur më parë dhe dhënien e një vendimi përfundimtar mbi të. Gjatë shqyrtimit, gjykata, në ushtrimin e funksioneve të saj, është e detyruar të hetojë të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, në tërësi dhe në mënyrë objektive dhe ta zgjidhë çështjen në themel.

Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se dhënia formë të prerë vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes në rastin e nenit 329/1 të KPP-së, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim deklarohet se fakti nuk ekziston”, i mohon individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë), si një nga elementet përbërëse të nenit 42/2 të Kushtetutës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës, me qëllim vendosjen në vend të një të drejte të cenuar nga një akt i pushtetit publik, ka për qëllim kontrollin e këtyre të fundit për respektimin e parimeve kushtetuese e ligjore në funksion të realizimit të drejtësisë. Në një shoqëri demokratike, e drejta e individit për t'u dëgjuar nga gjykata është një garanci e domosdoshme për të respektuar të drejtat dhe liritë e tjera themelore të shtetasve në një shtet të së drejtës (*shih vendimet e GJK-së nr.4, datë 10.2.2005; nr.21, datë 24.7.2006; nr.10, datë 4.4.2007; nr.26, datë 13.6.2007*).

Duke iu referuar edhe praktikës së GJEDNJ në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, si një element përbërës i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ është konstatuar, se vendimet e autoriteteve administrative duhet t'u nënshtrohen kontrollit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë, i cili duhet të sigurojë garancitë e tjera të kësaj Konvente. GJEDNJ ka vlerësuar vazhdimisht se kjo e drejtë është thelbësore dhe ka karakter parësor në një shoqëri demokratike për shkak të pasojave që ka në interesat legjitime të individit. Në vijim edhe të jurisprudencës më të fundit të po asaj Gjykate, autoriteti që ushtron kompetencën e rishikimit të një akti ose procesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur një balancë të drejtë midis interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale (*çështja “Bujnita kundër Moldavisë”, 16 janar 2007 dhe çështja “Xheraj kundër Shqipërisë”, 29 korrik 2008*).

Gjykata Kushtetuese, duke vlerësuar se ndodhet para një kufizimi me ligj të të drejtave themelore, e sheh të nevojshme ta kontrollojë dispozitën objekt shqyrtimi edhe sipas përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës, duke u ndalur konkretisht te plotësimi i kriterëve të kufizimeve të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga kjo dispozitë. Sipas nenit 17, kufizim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutë është i justifikuar, nëse ai vendoset me ligj për një interes publik ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë dhe në asnjë rast nuk duhet të prekë thelbin e lirive dhe të drejtave apo të tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Në zbatim të këtyre kriterëve të qarta dhe shterruese të kufizimeve të lirive dhe të drejtave themelore, Gjykata Kushtetuese, në praktikën e saj të konsoliduar, ka theksuar se një kufizim mund të jetë i përligjur dhe kushtetues vetëm kur bëhet në përputhje me kushtet e nenit 17 të Kushtetutës (*shih vendimet e GJK nr.9, datë 2.4.2003; nr.14, datë 5.7.2005; nr.35, datë 10.10.2007*).

Gjykata Kushtetuese, gjatë kontrollit të objektit të kërkesës, nuk arriti të evidentojë ndonjë interes publik apo të drejtë tjetër themelore, e cila mund ta ketë detyruar ligjvënësin të parashikojë përjashtimin e vetëm nga rastet kur individit mund t'i drejtohet gjykatës për të kundërshtuar vendimet e prokurorit, pra kur ky i fundit arrin në përfundimin se fakti nuk ekziston. Mosnënshtrimi i vendimit të

prokurorit kontrollit gjyqësor jo vetëm që prek të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por nuk mbron ndonjë interes publik, i cili, në parim, është më i prirur të ketë tendencë drejt rritjes së kontrollit gjyqësor ndaj akteve të pushtetit publik sesa në të kundërtën. Një gjë e tillë do t'i shërbente rrjedhimisht edhe rritjes së besueshmërisë së publikut te drejtësia duke shmangur çdo përpjekje për vendimmarrje abuzive nga organet e pushtetit publik.

Në vijim të kësaj logjike Gjykata Kushtetuese nuk e gjen të zbatuar në ndërhyrjen e ligjvënësit parimin e proporcionalitetit midis ndërhyrjes dhe nevojës që ka diktuar atë. Për më tepër, rezulton se dispozita objekt shqyrtimi është në kapërcim edhe të kriterit më esencial të kufizimit, konkretisht paprekshmërisë së thelbit të së drejtës përballë çdo kufizimi. Moslejimi i ankimit ndaj vendimit të prokurorit i ka mohuar tërësisht individit përballjen e tij me drejtësinë në rastin e nenit 329/1 të KPP-së, duke mosparashikuar asnjë mundësi rishikimi të tij nga një organ i pavarur dhe i paanshëm, siç është gjykata.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar prej saj, Gjykata Kushtetuese vlerëson se neni 329/1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston”, bie ndesh edhe me përmbajtjen e nenit 17 të Kushtetutës, i cili parashikon kriteret e kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore që duhen respektuar në çdo rast nga ligjvënësi.

Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese konkludon se ankimimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit duhet të garantohet në çdo rast, gjë e cila nuk është respektuar nga ligjvënësi në rastin e nenit 329/1 të KPP, duke e bërë përmbajtjen e tij antikushtetuese. Në këtë këndvështrim, dispozita e këtij neni cenon garancinë e vendosur nga neni 42/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kushdo, për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Përfshirimi i shkronjës “a” të nenit 328 nga rastet e ankimit përbën një kufizim të së drejtës së përgjithshme të aksesit në gjykatë, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës.

2. Lidhur me cenimin e të drejtës së ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës

Gjykata e Apelit Vlorë e mbështet vendimin e saj kryesisht në argumentin se neni 329/1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston”, i KPP-së cenon të drejtën e ankimit të individit të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese gjatë kontrollit konkret të një norme duhet t'u përgjigjet të gjitha pretendimeve dhe argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, ajo e sheh me vend të ndalet edhe tek ky argument i shprehur në arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Neni 43 i Kushtetutës parashikon se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Gjykata Kushtetuese vlerëson se e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor është një nga të drejtat themelore të individit, e cila mbi bazën e parashikimit kushtetues gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale konkrete. Në këtë mënyrë, çdo dispozitë ligjore që nuk respekton përmbajtjen e nenit 43 të Kushtetutës, duke sjellë si pasojë cenimin e një të drejte themelore të individit, konsiderohet si e papajtueshme me Kushtetutën dhe si e tillë duhet shfuqizuar.

Në çështjen objekt kërkesë, Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta e ankimit e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës duhet kuptuar si një mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim. Në këtë kuptim, përmbajtja e nenit 329/1 të KPP-së nuk ka për objekt ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimeve gjyqësore por ndaj vendimeve të prokurorit. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozita objekt shqyrtimi nuk mund të kontrollohet duke iu referuar përmbajtjes dhe kriterëve të nenit 43 të Kushtetutës.

Për sa më lart, Gjykata Kushtetuese çmon se parashikimi i nenit 329/1 të KPP-së, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim deklarohet se fakti nuk ekziston”, nuk rezulton të jetë në përputhje me përmbajtjen e nenit 42 dhe të nenit 17 të Kushtetutës, pasi cenon individin në të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatës si element përbërës i procesit të rregullt ligjor dhe përbën një kufizim të papërligjur nga pikëpamja kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 145/2 të Kushtetutës

dhe të nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 329/1, pjesa e fjalisë “përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston”, të KPP-së.

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 24/5, 327 pika 2 dhe 328 të KPP-së.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtar pro: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi

Anëtarë kundër: Sokol Berberi

VENDIM

Nr.6, datë 6.3.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar	i	“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 10.6.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10/1 Akti, që i përket:

KËRKUES: “Alb Toronto Konstruksion” sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Jani Xhumari dhe Ana Xhumari, përfaqësuar nga z.Gjergji Hysa me prokurë.

ZYRA E PËRMBARIMIT, përfaqësuar nga z.Julian Ahmeti, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 134/g të Kushtetutës, neni 6 i Konventës Europiane për të drejtat e njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara, zyrës së përmbarimit dhe Jani e Ana Xhumari, që kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin gjyqësor nr.263 datë 10.2.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen civile me palë: paditës i kundërpaditur - “Alb Toronto Konstruksion” sh.p.k., të paditur-kundërpaditës - Jani e Ana Xhumari etj., me objekt lirim dhe dorëzim sendi, është vendosur rrëzimi i kërkesës së kërkuarit, pranimi i kundërpadisë, duke vendosur zgjidhjen e kontratave përkatëse të sipërmarrjes.

Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e kërkuarit, me vendimin nr.1107, datë 11.11.2005, ka

vendosur ndryshimin e vendimit nr.623, datë 10.2.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; pranimin e padisë së shoqërisë “Alb Toronto Konstruksion” sh.p.k., duke e detyruar të paditurin kundërpaditës Jani e Ana Xhumari për të liruar e dorëzuar truallin me sipërfaqe prej 452 m² që ndodhet në rrugën “S.Pasha”, nr.21, Tiranë dhe rrëzimin e kundërpadisë dhe kërkesës së ndërhyrësve kryesorë.

Mbi rekursin e bërë nga Ana e Jani Xhumari, Gjykata e Lartë, me vendimin nr.1175, datë 13.10.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit për shqyrtim në seancë.

Subjektet e interesuara, Jani e Ana Xhumari, kanë kërkuar në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin e vendimeve të lartpërmendura, me pretendimin se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.37, datë 15.10.2005, ka rrëzuar kërkesën e Ana e Jani Xhumarit.

Në zbatim të vendimit të formës së prerë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr.1360, datë 3.11.2006, i cili detyron zyrën e përmbarrimit të zbatojë vendimin civil të formës së prerë.

Zyra e përmbarrimit i drejtohet palës debitore (Jani e Ana Xhumarit) për lirimin dhe dorëzimin e truallit prej 452 m² duke e kthyer në shesh ndërtimi në favor të shoqërisë “Alb Toronto” sh.p.k., duke kërkuar për këtë ekzekutim edhe mbështetjen e forcave të policisë.

Në datë 20.12.2006, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave (DKBAA) i ka dërguar një shkresë zyrës së përmbarrimit Tiranë, ku i rekomandohet të mos veprojë për këtë ekzekutim. Nga zyra e përmbarrimit Tiranë i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit Gjyqësor (DPPGJ) nxjerrja e një udhëzimi mbi mënyrën se si do të procedohej për ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv. DPPGJ, me shkresën e datës 9.5.2008 ka udhëzuar Zyrën e Përmbarrimit Tiranë për vazhdimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm të këtij titulli ekzekutiv, duke përcaktuar në mënyrë konkrete hapat që duhen ndjekur nga përmbarruesi gjyqësor.

Më pas, Zyra e Përmbarrimit Tiranë ka kryer një sërë veprimesh procedurale, por vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk është ekzekutuar.

II

Kërkuesi pretendoi se i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore dhe i kërkon Gjykatës Kushtetuese të konstatojë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Subjekti i interesuar, Zyra e Përmbarrimit, parashtroi para Gjykatës Kushtetuese se ajo ka ndërmarrë hapat ligjorë për ekzekutimin e vendimit objekt shqyrtimi. Më konkretisht:

- Me shkresën nr.10414 Prot, datë 13.11.2006 ka urdhëruar palën debitore që brenda 10 ditëve nga marrja dijeni të bëjë ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor, duke liruar e dorëzuar truallin e mësipërm.

- Me mbarimin e afatit të ekzekutimit vullnetar, Zyra e Përmbarrimit filloi procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm. Me shkresën nr.6134, datë 19.5.2008 ka urdhëruar sërish palën debitore për ekzekutim vullnetar.

- Me shkresën nr.7667, datë 16.6.2008, ka njoftuar komisaratin e policisë nr.3, Tiranë, si edhe palët për datën dhe orën e ekzekutimit më 25.6.2008, ora 10.00. Ekzekutimi nuk është kryer, për shkak se personat debitorë, bashkë me banorë të lagjes, kanë penguar kryerjen e veprimeve përmbarrimore.

- Me shkresën nr.8342 Prot, datë 25.6.2008 përmbarruesi i çështjes ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për personat përgjegjës.

- Me shkresën nr.7342 është njoftuar sërish komisarati i policisë nr.3 Tiranë, si dhe palët për datën dhe orën e ekzekutimit, ato ishin data 3.7.2008, ora 11.30. Në këtë datë është konstatuar se, në sipërfaqen objekt ekzekutimi, ndodhej edhe një banesë dykatëshe me sipërfaqe ndërtimore 66 m².

- Zyra e Përmbarrimit ka kryer veprimet procedurale, duke bërë lirimin e truallit dhe dorëzimin e tij në favor të palës kreditore, me përjashtim të sipërfaqes prej 66 m² ku ndodhej banesa dykatëshe. Për këtë të fundit Zyra e Përmbarrimit i ka kërkuar palës kreditore që të kërkojë pranë gjykatës kompetente sqarimin dhe interpretimin e pjesës urdhëruese (dispozitivit) të titullit ekzekutiv në lidhje me faktin nëse Zyra e Përmbarrimit duhet të lirojë dhe dorëzojë truallin (duke prishur banesën e

ndodhur brenda kësaj sipërfaqe) prej 452 m² palës kreditore apo duhet të mjaftohet vetëm me lirim e pjesës së truallit që është e lirë.

Subjektet e interesuara, Jani e Ana Xhumari, parashtrojnë para Gjykatës Kushtetuese se:

- Objekti i kërkesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga shoqëria “Alb Toronto” sh.p.k., është shqyrtuar më parë nga kjo gjykatë me vendimin nr.37, datë 15.10.2007.

- Pretendimi se ekzekutimi i vendimit gjyqësor është penguar nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikontrabandës nuk ka të bëjë me procesin e rregullt gjyqësor.

- “Alb Toronto” sh.p.k. është në konflikt me të gjithë pronarët që përfshihen brenda sheshit të ndërtimit.

- Vlefshmëria e lejes për prishjen e ndërtimeve ekzistuese mbi truall ka përfunduar pa ekzekutuar. Afati ka qenë tre muaj.

- Zyra e Përmbarimit nuk mund të prishë shtëpinë e Jani e Ana Xhumarit, e cila është pasuri e paluajtshme e regjistruar.

- Kërkuesi nuk i ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

- Në vendimin gjyqësor që kërkohet të ekzekutohet, gjykata nuk është shprehur për prishjen e shtëpisë së banimit.

III

1. Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuara Jani e Ana Xhumari se Gjykata Kushtetuese e ka gjykuar një herë këtë çështje

Subjektet e interesuara Jani e Ana Xhumari kanë pretenduar se Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e ka gjykuar një herë më parë objektin e kërkesës në shqyrtim të paraqitur nga kërkuesi, shoqëria “Alb Toronto” sh.p.k., me vendimin nr.37, datë 15.10.2007.

Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pambështetur, pasi objekti i vendimit nr.37, datë 15.10.2007 është “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.1107, datë 11.11.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1175, datë 13.10.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”. Objekti i çështjes së paraqitur në kërkesë ka të bëjë me konstatimin e cenimit të procesit të rregullt si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe është qartazi i ndryshëm nga objekti i vendimit të pretenduar.

2. Lidhur me pretendimin për mosshkrimin e mjeteve ligjore nga kërkuesi

Kërkuesi pretendon se i ka shteruar të gjitha mjetet e tjera ligjore lidhur me këtë çështje para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ndërsa subjektet e interesuara Jani e Ana Xhumari pretendojnë të kundërtën.

Individi, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se shkrimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. (*Vendimin nr.6, datë 31.3.2006; vendimi nr.27, datë 20.06.2007*). Shkrimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila, në çështjen “*Qufaj kundër Shqipërisë*”, është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore që, sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

Shkrimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga ankuesi, i cili, para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura.

Gjykata Kushtetuese mban parasysh se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr.1360, datë 3.11.2006 në zbatim të vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1107, datë 11.11.2005. Rrjedhimisht, kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ndaj legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

3. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm

Gjykata është shprehur edhe më parë se parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor

dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenet 42 dhe 142/3 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së nënvizojnë faktin se çdo qytetar i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj.

Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*vendimi nr.27, datë 20.6.2007 i Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*vendimi nr.6, datë 31.3.2006 i Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata thekson se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.43, datë 19.12.2007*).

Gjykata rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

Ekzekutimi i vendimeve brenda afatit të arsyeshëm ka qenë në fokusin e vazhdueshëm edhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Ajo pohon se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, si pjesë e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, është element i procesit të rregullt gjyqësor sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, të gjitha shtetet detyrohen të organizojnë sistemin juridik në mënyrë të tillë që gjykatat të mundësojnë shqyrtimin e të gjitha çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, sepse sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa që çojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në to (*shih çështjen "Bageta kundër Italisë", vendim i datës 25.6.1998 i GJEDNJ-së*). GJEDNJ-ja ka sqaruar se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai (*shih çështjen "Giralanci kundër Italisë", vendim i datës 19.2.1999, GJEDNJ*), apo se faza ekzekutive duhet të llogaritet, pra të konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih çështjen "Vakaturu kundër Italisë", vendim i datës 25.5.1991, GJEDNJ*). Gjykata ka konfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Përsa i përket sjelljes së aplikantit/kërkuesit, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Përsa i përket sjelljes së autoriteteve, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme. (*vendimi "Cravcenko kundër Moldavisë", GJEDNJ, datë 15.4.2008*)

Me qëllim analizimin e sjelljes së palëve në dritën e standardeve kushtetuese, Gjykata merr në konsideratë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC ose Kodi) lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto dispozita sqarojnë procedurat ligjore të cilat duhen plotësuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor. Neni 451/a (paragrafi i parë) i këtij Kodi parashikon se vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga

palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Neni 510 i Kodit parashikon se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv dhe se janë tituj ekzekutivë, ndër të tjera vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. Neni 511 parashikon se titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit dhe për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile. Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, ndër të tjera, edhe me kërkesën e kreditorit (neni 515). Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të bëhet fillimisht me ekzekutim vullnetar. Kështu, neni 517 i Kodit parashikon kriteret për lajmërimin për ekzekutim vullnetar, sipas të cilit përmbaruesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh kur objekti është pagë ose detyrim për ushqim dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera. Neni 518 parashikon se lajmërimi duhet, ndër të tjera të përmbajë paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm në qoftë se ekzekutimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim. Neni 519 i Kodit të Procedurës Civile parashikon kriteret për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, i cili nuk mund të fillojë para se të kenë kaluar afatet e parashikuara në nenin 517.

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata çmon të nevojshme të vlerësojë nëse Zyra e Përmbarimit ka marrë ndonjë masë për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe në këtë mënyrë të vlerësojë veprimet ose mosveprimet për një kohë të gjatë në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

Zyra e Përmbarimit ka sqaruar para Gjykatës se ajo ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe më konkretisht me shkresën nr.10414 Prot., datë 13.11.2006 ka urdhëruar palën debitore që brenda 10 ditëve nga marrja dijeni të bëjnë ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor duke liruar e dorëzuar truallin e mësipërm. Me shkresën nr.6134, datë 19.5.2008 e ka urdhëruar sërish palën debitore për ekzekutim vullnetar. Me shkresën nr.7667, datë 16.6.2008 ka njoftuar komisaratin e policisë nr.3, Tiranë, si edhe palët për datën dhe orën e ekzekutimit më 25.6.2008, ora 10.00. Ekzekutimi nuk është kryer për shkak se personat debitorë bashkë me banorë të lagjes kanë penguar kryerjen e veprimeve përmbarimore. Me shkresën nr.7342 është njoftuar sërish komisarati i policisë nr.3 Tiranë, si dhe palët për datën dhe orën e ekzekutimit, e cila do të ishte me datë 3.7.2008, ora 11.30. Në këtë datë është konstatuar se në sipërfaqen objekt ekzekutimi ndodhej edhe një banesë dykatëshe me sipërfaqe ndërtimore 66 m². Zyra e Përmbarimit sqaron edhe se ka kryer veprimet procedurale, duke bërë lirim të truallit dhe dorëzimin e tij në favor të palës kreditore, por vetëm të sipërfaqes së lirë të truallit, me përjashtim të sipërfaqes prej 66 m² ku ndodhej banesa dykatëshe. Për këtë të fundit Zyra Përmbarimore i ka kërkuar palës kreditore që të kërkojë pranë gjykatës kompetente sqarimin dhe interpretimin e pjesës urdhëruese (dispozitivit) të titullit ekzekutiv në lidhje me faktin nëse Zyra e Përmbarimit duhet të lirojë dhe dorëzojë truallin (duke prishur banesën e ndodhur brenda kësaj sipërfaqe) prej 452 m² palës kreditore, apo do të mjaftohet duke liruar atë pjesë të truallit që është e lirë.

Gjykata vëren se vendimi i formës së prerë, i cili kërkohet të ekzekutohet, i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1107, datë 11.11.2005 për pranimin e padisë së shoqërisë “Alb Toronto Konstruktion” sh.p.k., e detyron të paditurin kundërpaditës Jani e Ana Xhumari për të liruar e dorëzuar truallin me sipërfaqe prej 452 m² që ndodhet në rr. “S.Pasha”, nr.21 Tiranë.

Përsa i përket sjelljes (veprimeve) së kërkuesit, Gjykata konstaton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e të drejtës së cenuar.

Përmbaruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor nuk kanë arritur në ekzekutimin e titullit ekzekutiv për shkak të mosushtrimit të të gjitha kompetencave nga ana e tij dhe vonesat për rreth një vit e gjysëm nga data e urdhrin të ekzekutimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nga kërkuesi. Gjykata nuk e gjen të bazuar as argumentin se vendimi gjyqësor është zbatuar, por, pjesësisht, me dorëzimin e lirit të sendit përveç pjesës së zënë prej 66 metra katrorë ku ndodhet godina. Gjykata vlerëson se një vendim gjyqësor quhet i ekzekutuar kur ekzekutohet dispozitivi i vendimit në tërësinë e tij. Kjo nuk ka ndodhur në rastin në shqyrtim.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e

të drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor për shkak të moszekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga organet kompetente.

Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se moszekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuarit të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 të KEDNJ.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.1107, datë 11.11.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Gjergj Sauli, Fehmi Abdiu, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi
Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori

VENDIM Nr.7, datë 9.3.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 11.11.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.24/10 Akti që i përket:

KËRKESË: Qemal Driza, i biri i Aliut, datëlindja 1950, banues në Tiranë, kompleksi “Halili”, shk.E, kati 5 - i përfaqësuar nga avokat Avni Shehu – me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Hamid Driza, i biri i Aliut, datëlindja 1945, banues në Tiranë, rr. “Ali Demi”, p.261, shk. 4, ap. 47, i përfaqësuar nga avokat Alket Hyseni - me prokurë të posaçme.

Sali Driza, biri i Aliut, datëlindja 1941, banues në Tiranë, rr. “Elbasanit”, p.4, shk. 3, ap. 20, i përfaqësuar nga avokat Alket Hyseni - me prokurë të posaçme.

Dije Kazazi (Driza), e bija e Aliut, banuese në Tiranë, rr. “Ali Demi”, nr.18.

Fatbardha Ruci (Driza), e bija e Aliut, banuese në Tiranë, rr. “Gani Domi”, p. 3, shk. 1, ap. 7.

OBJEKTI: 1. Shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

2. Pezullimin e këtij vendimi deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

BAZA LIGJORE: Neni 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoji pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoji rrëzimin e kërkesës dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuari Qemal Driza është palë në një konflikt me karakter pasuror me subjektet e interesuara, të cilët janë të gjithë fëmijë të të ndjerit Ali Driza. Ky i fundit, ka pasur në pronësi të tij, disa prona të paluajtshme, të cilat nëpërmjet kontratave të hartuara në vitin 1991, 1993 dhe 1994 ia ka dhuruar kërkuarit. Subjektet e interesuara, duke pretenduar për disa parregullsi ligjore të dokumentacionit që e ka bërë kërkuarin pronar të vetëm të pasurisë, i janë drejtuar gjykatës, me padi me objekt *“detyrimin e të paditurit të njohë edhe ata si bashkëpronarë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik të regjistrimit të një akti njoftunie dhe të kontratave përkatëse të dhurimit”*.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.3984, datë 20.6.2005, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pa mbështetur në ligj dhe prova”*.

Gjykata e Apelit Tiranë, pas ankimit të personave të interesuar, me vendimin nr. 1035, datë 2.10.2006 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 3984, datë 20.6.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”*.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pas rekursit të bërë nga subjektet e interesuara Hamid e Sali Driza, me vendimin nr. 166, datë 6.3.2008, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 1035, datë 2.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 3984, datë 20.6.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë së paditësve duke u detyruar i padituri Qemal Driza t'i njohë bashkëpronarë sipas pjesëve që trashëgojnë nga pasuria e trashëgimlënësit.”*

Kërkuari, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka kundërshtuar si antikushtetues vendimin nr. 166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime kryesore:

- Në gjykimin në Gjykatën e Lartë nuk janë respektuar nenet 472 e 485 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat lidhen me kompetencën. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka rivlerësuar provat e marra gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit, duke i ndryshuar rrethanat e çështjes. Duke vlerësuar si të falsifikuar apo të pavërtetë nënshkrimin e palëve në kontratë, nga një vështrim pamor dhe pa iu nënshtruar më parë ekspertimit ligjor, Gjykata e Lartë ka marrë kompetencat që i përkasin ekspertit;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij, duke e zgjidhur çështjen në themel, ka dalë jashtë kërtimeve të palëve, pasi është shprehur për pavlefshmërinë e një kontrate dhurimi të vitit 1998, që nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, ndërkohë që nuk është shprehur për të gjithë objektin e mosmarrëveshjes dhe për gjithçka që është kërkuar në gjykim;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e sigurisë juridike, sepse nuk ka marrë në konsideratë dy vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilët vërtetë pronësinë e kërkuarit mbi pronat, objekt shqyrtimi;

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe jo logjik. Sipas kërkuarit citohen paragrafë të veçantë që kundërshtojnë njëri-tjetrin, ku nga njëra anë pranohet se dhuruesi nuk ka qenë pronar dhe nga ana tjetër detyrohet të njohë pronësinë mbi të paditurit.

Përfaqësuesi i subjekteve të interesuara, Hamid e Sali Driza, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar :

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka administruar prova të reja. Është në kompetencën e Gjykatës së Lartë të bëjë vlerësimin e fakteve dhe të normave juridike, si dhe të verifikojë zbatimin dhe interpretimin e ligjit. Argumentet e parashtruara në vendimin e Gjykatës së Lartë tregojnë për

keqinterpretimin, mënjanimin apo zbatimin e gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale të kryer nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

- Gjykata nuk ka cenuar parimin e disponibilitetit të palëve, për arsye se gjykata ka shpallur kontratat e dhurimit si absolutisht të pavlefshme, për shkak të kërimit të bërë nga vetë paditësit.

- Pretendimi i kërkuarit për alogjizmin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i pabazuar. Nga citimet e vetë kërkuarve rezulton se Ali Driza ka qenë kërkuar dhe pretendues për këto prona, ndaj nuk mund të bënte tjetërsimin e tyre para daljes së vendimit të komisionit të kthimit të pronave, moment në të cilin është bërë pronar me të drejta të plota.

- Nuk qëndron pretendimi për cenim të parimit të sigurisë juridike. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë ndërhyrje në dy vendimet gjyqësore të vitit 1991. Objekt i këtij gjykimi nuk kanë qenë këto vendime gjyqësore, por vetëm kontratat e dhurimit. Të dy vendimet gjyqësore, me anë të të cilave është detyruar ish-ndërmarrja shtetërore, që nuk kishte të drejtën e tjetërsimit të pronës shtetërore kanë qenë të paekzekutueshme dhe nuk përbënin detyrim ndaj shtetit.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Dije Kazazi (Driza), ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar :

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka ndryshuar rrethanat e çështjes dhe nuk ka bërë rivlerësim të provave të marra nga gjykata e shkallës së parë dhe e apelit. Duke konstatuar se faktet dhe rrethanat e çështjes nuk nxjerrin përfundime ligjore si ato të pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, Kolegji Civil ka arritur në përfundimin, se kontratat e dhurimit janë absolutisht të pavlefshëm si në përmbajtje, ashtu edhe në formë.

- Arsyetimin e vendimit të tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka të bazuar në ligj. Nxjerrja e konkluzionit për alogjizmin e një vendimi gjyqësor nuk mund të arrihet duke shkëputur pjesë të veçanta të tij në mënyrë subjektive.

II

1. Në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në fillim të seancës plenare, Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata), pasi dëgjoi pretendimet e palëve për kërkimin që lidhet me pezullimin e vendimit nr. 166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendosi rrëzimin e kërkesës si të pabazuar, me arsyetimin se zbatimi i tij nuk rezulton të pasohet nga cenime të interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit kushtetues të “gjykatës së caktuar me ligj”.

Në kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës kërkuar i referohet rregullimit kushtetues të parashikuar në nenet 42 dhe 131, shkronja “F” të Kushtetutës, të cilat lidhen me respektimin e standardit “*të gjykatës së caktuar me ligj*”, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kërkuar pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 166, datë 6.3.2008 ka tejkaluar kompetencat e parashikuara nga ligji procedural civil, pasi nëpërmjet rivlerësimit të provave të marra gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe në gjykatën e apelit, ka ndryshuar rrethanat e çështjes. Në këtë proces gjyqësor, Kolegji Civil ka marrë gjithashtu edhe kompetencat e ekspertit kur ka vlerësuar si të falsifikuar e të pavërtetë nënshkrimin e dhuruesit në kontratat e dhurimit të pronës objekt gjykimi.

Gjykata thekson se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (shih vendimin nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata vlerëson se kompetenca për shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata e Lartë nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale, të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Kompetencat e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë të parashikuara në nenet 472 dhe 485 të

Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta, mbi një analizë tërësore të të gjitha provave dhe rrethanave të çështjes. “Neni 485 i Kodit të Procedurës Civile i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si edhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave të instancave më të ulëta, por nuk i ka dhënë të drejtë, që mbi bazën e vlerësimit të provave, të prishin të dy vendimet e të rrëzojnë kërkesë padinë dhe as t’i ndryshojnë ato duke vendosur rrëzimin e padisë. (shih vendimi nr.31, datë 1.12.2005).

Në jurisprudencën e Gjykatës është konkluduar se “nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë.” Sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ky kolegji ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por pa bërë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta. (shih vendimin nr.17, datë 30.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të mbahet i njëjti qëndrim lidhur me parregullsinë e procesit ligjor kur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prish vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit.

Nisur nga natyra e veçantë e këtij gjykimi, Gjykata thekson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykata e shkallës së parë dhe e apelit. (shih vendimi nr.31, datë 1.12.2005). Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe e apelit dhe pa i ndryshuar ato.

Duke analizuar rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka konkluduar ndërmjet të tjerave se: “... faktet dhe rrethanat e çështjes nuk janë ashtu siç i kanë pranuar apriori të dy gjykatat e faktit”. Ky kolegji ka konkluduar se “është shpronësuar prona e Ali Drizës”, ndërkohë që për të njëjtin fakt në vendimin e gjykatës së apelit “rezulton se nuk kanë qenë të shpronësuar”.

Këto deklarime të Kolegjit Civil, pasohen nga analiza e fakteve dhe e rrethanave, e ndryshme nga ajo që kanë bërë gjykatat më të ulëta. “Në kundërshtim me sa kanë pranuar dy gjykatat e faktit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, analizon faktet dhe rrethanat” duke vënë në dyshim vërtetësinë e nënshkrimit në kontratat e dhurimit të hartuara përpara noterit. Gjykata thekson se lindja e çdo dyshimi të arsyeshëm mbi vërtetësinë e nënshkrimit në aktet objekt shqyrtimi nuk i jep të drejtë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të konkludojë mbi falsitetin apo pavërtetësinë e dokumentit, pa u shprehur më parë eksperti për një çështje të tillë. Bazuar mbi një vlerësim të ndryshëm të provave dhe të fakteve që janë dhënë nga gjykata e faktit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, duke pranuar padinë e paditësve.

Në kërkesë është pretenduar gjithashtu si një argument për parregullsinë e procesit gjyqësor edhe mosmarrja në konsideratë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i dy vendimeve gjyqësore të formës së prerë, që vërtetonin pronësinë e kërkuarit mbi pronat objekt gjykimi. Siç rezulton nga dosja gjyqësore, nëpërmjet dy vendimeve nr. 1176, datë 18.06.1991 dhe nr. 2222, datë 19.10.1991 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me objekt të padisë rivendikimin e sendit, trashëgimlënësi i kërkuarit, në cilësinë e pronarit të disa pronave të pashpronësuar, ka kërkuar nga ish-ndërmarrja shtetërore kthimin e tyre. Pikërisht, bazuar mbi këto fakte e rrethana kanë vendosur zgjidhjen e çështjes gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, ndërkohë që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke mënjанuar zbatimin e të dy vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ka konkluduar se “këto vendime gjyqësore nuk ishin të ekzekutueshme.”

Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksohet se shteti i së drejtës, i cili garantohet që në preambulën e Kushtetutës sonë, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, i cili kërkon, midis të tjerash, që vendimet e formës së prerë të gjykatave të mos

vihen në diskutim. (shih vendimi nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese dhe çështjen “Brumărescu kundër Rumanisë”; vendim i datës 28.10.1999 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut).

Gjykata thekson se të dy vendimet gjyqësore të cilave nuk u është referuar Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e çështjes janë në fuqi dhe si të tilla mbeten të detyrueshme për t’u zbatuar në çdo kohë. Duke marrë një vendim në tejkalim të kompetencave të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, Gjykata konkludon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të gjykatës së “*caktuar me ligj*”.

3. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të disponibilitetit

Kërkuesi pretendon se Kolegji Civil ka cenuar parimin e disponibilitetit, pasi në vendimin e tij nuk është shprehur për të gjithë objektin e mosmarrëveshjes dhe për gjithçka që është kërkuar nga pala paditëse në objektin e padisë.

Parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 2 të Kodit të Procedurës Civile. Iniciativa për të filluar procesin i takon palës së interesuar, sepse gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari - “*Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe*” (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile). Në çdo rast është pala që tregon objektin e gjykimit, kështu që gjykata nuk mund të dalë jashtë objektit të padisë. Pra “*gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet*” (neni 6 i Kodit të Procedurës Civile).

Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. “Në gjykimet kushtetuese të kësaj natyre, kur janë konstatuar raste të tejkalimit nga ana e gjykatave të kërkesave të parashtruara në një padi, ato janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si elemente thelbësore që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut” (Shih vendimin nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese).

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi ka qënë në pozitën procedurale të të paditurit, ndërkohë që ka qënë paditësi ai që ka ushtruar të drejtën e tij për rekurs në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se, përderisa objekti i gjykimit është përcaktuar nga kërkimet e palës paditëse, (nenet 6 dhe 16 të Kodit të Procedurës Civile) kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*.

4. Lidhur me pretendimin për mos arsyetimin e vendimit gjyqësor

Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor duke argumentuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dhënë një vendim kontradiktor dhe jologjik. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. “Gjyqësori, në kryerjen e funksioneve i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara (neni 142)... Kodi i Procedurës Civile parashikon, se gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor. Vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë... Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse. Dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve”(shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata ka theksuar se: “Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërtënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshëm për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik” (shih vendimi nr.33, datë 8.12.2005 të

Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata vlerëson se vijueshmëria logjike e arsytimit konstatohet nga leximi integral i vendimit dhe nuk mund të deduktohet nga pasazhe të shkëputura. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se të dy paragrafët e sjellë nga ana e kërkuarit si argumente të arsytimit jo logjik të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë pjesë të shkëputura nga kontekste të ndryshme. Ndërsa i pari i referohet aktit të njohjes së pronësisë nga një vendim i komisionit të kthimit të pronave të vitit 1994, citimi i dytë i referohet dy kontratave të dhurimit të lidhura respektivisht në vitet 1991 dhe 1993. Nga kjo pikëpamje, pretendimi i kërkuarit për një arsyetim jologjik e kontradiktor të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i pabazuar.

Përfundimisht Gjykata konkludon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuarit lidhur me konceptin “*gjykatë e caktuar me ligj*”, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Vitore Tusha

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), (Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Kujtim Puto

MENDIM PAKICE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.166, datë 6.3.2008 ka ndryshuar vendimet nr.1035, datë 2.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.3984, datë 20.6.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar padinë e subjekteve të interesuara Sali Driza dhe Hamid Driza dhe duke detyruar kërkuarin Qemal Driza t’i njohë ata bashkëpronarë sipas pjesëve që trashëgojnë nga pasuria e trashëgimlënësit Ali Driza.

Shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në kundërshtim me qëndrimin e shumicës, jemi të mendimit se vendimi i Kolegjit Civil nuk duhej shfuqizuar si antikushtetues.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ajo e Apelit Tiranë, në vendimet e tyre, kanë pranuar ndër të tjera se i ati i ndërgjyqësve, Ali Driza, ka pasur në pronësi disa objekte si: truall me sipërfaqe 867 m² me dyqane, banesë etj., qysh para vitit 1944. Për këto prona, pas vitit 1990 ai ka bërë disa kontrata me të cilat ia ka kaluar gjithë pronësinë njërit prej fëmijëve të tij, kërkuarit Qemal Driza. Gjykatat kanë pranuar gjithashtu se Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave i ka kthyer trashëgimlënësit Ali vetëm sipërfaqen e shtetëzuar prej 192 m², ndërsa pjesa tjetër prej 627 m², me gjithë ndërtesat, nuk i është kthyer me vendim të Komisionit, por me dy vendimet gjyqësore të vitit 1991, që detyronin për këtë kthim Ndërmarrjen Tregtare të Ushqimit Social.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (Kolegji), në ndryshim nga gjykatat e mësipërme ka pranuar

se trashëgimtarit të palëve nuk i është kthyer sipërfaqja prej 627 m² në vitin 1991 me vendimet e gjykatave, sepse këto të fundit, sipas atij Kolegji, ishin të paekzekutueshme. Kolegji vlerësoi se meqë Ndërmarrja Tregtare nuk ishte disponuese e pronës shtetërore, duhet pranuar se pronat janë kthyer vetëm me vendim të Komisionit në vitin 1994. Kolegji Civil ka pranuar gjithashtu se kontratat me të cilat ka kaluar pronësia nga trashëgimlënësi te kërkuesi janë veprime juridike absolutisht të pavlefshme sepse, duke qenë me të meta thelbësore në përmbajtje dhe formë, ato vijnë në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore të kohës.

Lidhur me vlerësimet për vlefshmërinë e kontratave të kalimit të pronësisë, Kolegji nuk ka dalë jashtë kompetencave të veta dhe as i ka cenuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes. Kolegji Civil ka pranuar ekzistencën e kontratave dhe, në përputhje me kërkesat e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë interpretimin juridik të formës e përmbajtjes së kontratave të dhurimit në favor të kërkuesit dhe ka pranuar se nuk është respektuar ligji. Në përfundim, ai i ka konsideruar ato të pavlefshme dhe, si të tilla, nuk mund të shërbenin si bazë për kalimin e pronësisë vetëm te kërkuesi. Si rrjedhojë, janë njohur si bashkëpronarë të gjithë trashëgimtarët dhe jo vetëm kërkuesi.

Vendimi i mësipërm i Kolegjit Civil nuk ka cenuar elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Funkzioni rishikues i Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës kërkon që Gjykata e Lartë së pari, të aplikojë të drejtën mbi faktet e konstatuara e të vlerësuara në mënyrë të pavarur nga gjykatat e rrethit e të apelit dhe, së dyti, të njësojë praktikën gjyqësore në bazë të interpretimit që u jep problemeve juridike, pra të interpretojë ligjin për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë në të gjithë territorin (*vendimi nr.31, datë 1.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese*).

Në çështjen në shqyrtim Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj rishikues, duke i dhënë vlerësim tjetër juridik rrethanave e fakteve të çështjes. Përmendja në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë se ai kolegji “vëren se faktet dhe rrethanat e çështjes nuk janë ashtu siç i kanë pranuar apriori të dy gjykatat e faktit”, nuk ka ndikim thelbësor në vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit. Kjo sepse edhe për faktet që Kolegji Civil i ka pranuar sipas konkluzioneve të gjykatës së rrethit e të apelit, interpretimi juridik i bërë prej tij ka determinuar në ndryshimin e vendimit të atyre gjykatave dhe pranimin e subjekteve të interesuara si bashkëpronarë në pasurinë e trashëgimlënësit.

Anëtar: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Petrit Pllloçi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.3.2009
Doli nga shtypi më 19.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë